



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:152020
Datë: 29.11.2024
Numri i dokumentit: 06528068

C-II-18-0019-C0001

Gj H A

Përfaqësuar nga av.Rr L,Pejë

Ankuesja

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit (NSH “Trofta ”) Rr.Dritan Hoxha nr.55 Lakrishtë Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS) gjyqtarja Diellza Hoxha me date 29 nëntor 2024 lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Ankesa e paraqitur nga Gj H A hedhet poshtë si e pa pranueshme .**
- 2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesen.**

Rrethanat procedurale

Me 30.04.2018 ankuesja ka parashtruar ankesë në DHPGJS kundër AKP-së lidhur me kërkesën e saj për perfshirjen e saj në listën përfundimtare të 20 %. Ajo thekson se ka qenë punëtore e NSH “Trofta” prej vitit 1979 deri me 04.08.1992 kur edhe është dëbuar nga masat e dhunshme. Paditësja pas luftës është lajmëruar në vendin e punës në vitin 2001 mirëpo kërkesa e saj është refuzuar dy herë nga menxhmenti i NSH-se me arsyetim se nuk ka vend të lirë të punës kështu që i është mohuar mundësia që të punoj tri vite radhazi që të plotësoj kushtin për të hyrë ne listën e punësuarve të cilët kane qenë të paraparë të përfitojnë nga procesi I privatizimit të NSH-se. Ajo thekson se ajo edhe pse ka punuar me tepër se 13 vite në këtë NSH nuk është përfshirë ne

listën përfundimtare të 20% andaj Gjykatës i propozon që ankesën e saj ta marrë në konsideratë dhe të aprovojë në tërësi, ta obligojë të paditurën të regjistroj në Listën përfundimtare të punëtorëve të cilët kanë të drejtë në një pjesë të 20%. Në mbështetje të ankesës nuk ka parashtruar asnjë provë.

Dhoma e Posaçme ia dërgoi AKP-së ankesën e ankueses.

Më 10 maj 2018 AKP-ja në përgjigjen e saj deklaroi se ankuesja ka lëshuar afatin ligjor për parashtrimin e ankesës në bazë të nenit 10.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qene më 27.09.2004 ndërsa ankesa është parashtruar më 03.04.2018. Ankuesja madje nuk mund të paraqes as kërkesë për përsëritjen e procedurës. Sipas nenit 130.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore afati për parashtrimin e një kërkesë të tilla është 60 ditë nga dita e nxjerrjes së vendimit.

Andaj i propozon gjykatës që ankesën ta hedhe poshtë si të pa pranueshme.

Arsyetim ligjor

Ndërmarrja Shoqërore NSH “Trofta Istog është privatizuar me 08.03.2004, Lista përfundimtare e punëtorëve të cilët kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes së lartë shënuar për 20%, është shpallur në gazeta ditore dhe afati i fundit për ushtrimin e ankesave kundër listës përfundimtare të punëtorëve, ka qenë më 27.09.2004.

Ankuesja ka parashtruar ankese me 03.04.2018

AKP-ja pretendon se ankesa është parashtruar pas afatit kohor.

Procedura për parashtrimin e ankesës në Dhomës e Posaçme përcaktohet në nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut (e ndryshuar), e cila thotë: “Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime”.

Gjykata konstaton se ankesa është parashtruar më 3.04.2018 pas afati të lejuar me ligj madje edhe pas afati të lejuar për parashtrimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës.

Përcaktimi i afateve ligjore nga ligjvënësi brenda të cilit duhet ndërmarrë një veprim bëhet me qellim të zhvillimit të një procedure më të shpejtë dhe më të drejtë, që janë parime të përgjithshme për të gjitha procedurat gjyqësore në të kundërtën do të cenonte sigurinë juridike.

Andaj Ankesa duhet hedhur poshtë si e pa pranueshme .

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore,

të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, punëtorët lirohen nga pagesa e taksës gjyqësore.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha _____
Gjyqtare